



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT

Zyra e Kryetarit

Numër 400-1179



**RAPORT I BUXHETIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2010**

DRENAS, SHKURT 2011

RAPORT I BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2010

kërkesë për raportim

Në bazë të nenit 46.2 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Kryetari i Komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë Kuvendit të Komunës një raport përfundimtar përmbledhës buxhetor i cili përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 46.1, që aplikohen për komunat, më pastaj edhe do të publikohet në faqën e internetit të Komunës, për të përmbushur principin e transparencës, lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal.

Pjesa e më poshtme përfshin një përmbledhje të të dhënave fiskale.

Ndarjet buxhetore

Ligji nr.03/ L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës i paraqet ndarjet buxhetore finale 2010 Ky ligj përfshin edhe mekanizma që mundësojnë ndryshime të këtyre ndarjeve buxhetore gjatë vitit, këto mekanizma përfshijnë:

- * Ndarjen buxhetore të disa llojeve të të hyrave vetanake të mbledhura nga fushat kryesore të të hyrave në vitin paraprak e të pa shpenzuara,
- * Ndarjen buxhetore nga të hyrat të planifikuara për arkëtim gjatë vitit 2010 sipas fushave kryesore të të hyrave, dhe sipas sektorve kryesor,
- * Ndarjen buxhetore nga Grantet ndërqeveritare sipas drejtorateve - zyrëve komunale, si dhe
- * Ndarjen buxhetore nga të hyrat tjera.

1.Ndarjet buxhetore sipas Ligjit nr. 03/L-177

Nr.	Programet	Pag&Med	Mall&Sherb.	Sh.Komun.	Subven.	Sh.Kapitale	Nr. Punt.
1	Z. Kuvendit	97,960	3,083	360	15,000		
2	Z. Kryetarit	54,560	49,587	1,000			8
3	D. Administratës	156,539	57,942	38,100	4,700		44
4	D.Buxh&Financa	60,931	8,305	360			14
5	D.Inspeksionit	42,863	9,721	360			10
6	D.Buj&zhv.ekon.	38,099	18,730	798			12
7	D.Sherb.Publike	88,906	46,675	2,790	3,000	10,000	20
8	D.Gjeode&Kadas.	45,780	7,525	360			12
9	D.Urba&Mb.Mjedis.	42,529	13,460	360		2,039,305	9
10	D.Kult,Rini&Sport	57,611	23,807	360	21,000		15
11	D.Arsim	3,118,180	306,834	64,877	20,000	232,985	957
12	D.Shen&Mirqen.So	795,118	174,142	40,270	26,000	11,683	200
	Gjithsej:	4,599,076	719,811	149,995	89,700	2,293,973	1,301

Bazuar në tabelën e lartshenuar, vërehet se buxheti i çertifikuar me rishikim për vitin 2010, kapë shumën prej: 7,852,555 €.

Burimet kryesore të financimit janë :

1. Granti ndërqeveritar në shumë prej:7,104,288€, apo 90,47%; ku bëjnë pjesë:

- * Granti i Administratës në shumë prej:2,460,160€,
- * Granti i Arsimit në shumë prej:3,691,276€,
- * Granti i Shendetësisë në shumë prej:952,852€, si dhe

2. Të hyrat nga burimet vetanake në shumë prej:748,267€, apo 9,53%; ku bëjnë pjesë:

- * Të hyrat vetanake, Sektori i Administratës shuma prej:642,750€,
- * Të hyrat vetanake, Sektori i Arimit shuma prej:487,000€,
- * Të hyrat vetanake, Sektori i Shendetësisë shuma prej:57,517€.

Zhvillimi dhe analiza e buxhetit komunal 2010

Raporti financiar paraqet një pasqyrë të bilancit për të hyrat dhe të dalat-shpenzimet të realizuara në raport me planifikimin, për këtë të dhënat përmbledhëse për vitin 2010 do të pasqyrohen në tabelën e më poshtme:

2. Skema buxhetore për vitin 2010

Përshkrimi	Planifikimi	Realizimi	Përqindja
Të hyrat	8,047,998	8,071,033	100,29
Të dalat	8,047,998	7,859,067	97,65
Gjendja më 31.12.10		211,966	

Të dhënat e prezantuara në tabelën e lartë shenuar, janë të bazuara në raportin e Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës dhe evidencën financiare të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, ku pasqyrohet planifikimi-realizimi i të hyrave-dalava publike për vitin 2010; si dhe bilanci - gjendja më 31.12.010. Raporti i S I M F K-së paraqet buxhetin e planifikuar në shumë prej:8,047,998€; ndërsa Ligji mbi ndarjet buxhetore 03/L-177, paraqet shumën prej:7,852,555€, që nënë kupton rritje të planifikimit për shumën prej:218,478€; apo shprehur në përqindje 102,49%.

Realizimi i të hyrave në krahasim me planifikimin e të dhënave sipas Raportit të S I M F K-së, është realizuar në përqindje 100,29%; ndërsa krahasuar me planifikimin sipas ligjit të buxhetit për 102,78%. Të dalat-shpenzimet e realizuara, krahasuar me të dhënat e planifikuara sipas Raportit të SIMFK-së kemi realizimin e objektivit në përqindje 97,65%; ndërsa krahasuar me planifikimin sipas ligjit të buxhetit, përqindja e realizimit është 100,08%. Bilanci I gjendjes së 31.12.010 në shumë prej:211,966€, paraqet shumën e mjeteve të pa shpenzuara, Grantet e Qeverisë marrin pjesë me 5,145€, apo 2,43%; ndërsa të hyrat nga burimet vetanake marrin pjesë me 206,821€, apo shprehur në përqindje 97,57%. Vlen të theksohet se shuma e mjeteve të arkëtuara e të pa shpenzuara si të hyra nga burimet vetanake është arkëtuar në periodën e fundit të vitit fiskal 2010 dhe si e tillë bartet në buxhetin 2011, e cila shumë do të shpenzohet me vendim të Kuvendit të Komunës.

Në shumën e mjeteve të realizuara në vitin 2010, Grantet e Qeverisë marrin pjesë 90,44%; ndërsa të hyrat nga burimet vetanake me 9,56%. Zhvillimin e buxhetit komunal 2010 nëse e krahasojmi me atë të një viti më parë, do të kemi një rritje për +10,31%.


Me raportin e SIMFK-së, të hyrat e planifikuara në shumë prej:8,047,998€, janë akorduar në shumë prej:7,954,677€; apo shprehur në përqindje 98,84%, që nënë kuptohet se kanë mbetur për akordim mjete në shumë prej:93,322€.

Tabela 3. Të hyrat e burimeve vetanake të planifikuara-rishikuara për vitin 2010

Nr	Fushat e të hyrave	Planifikimi	Rishikimi	Realizimi	%me plan	%me rishik
1	Lejet-Licencat	87,600	87,600	74,533	85,08	85,08
2	Shf.i tokës-lejet e ndërtimit	64,000	75,683	90,063	140,72	119,00
3	Aktivitetët gjeodezike	29,000	44,526	44,677	154,06	100,34
4	Sherbimet e inspektimit	4,400	4,400	2,060	46,82	46,82
5	Shfrytzimi I pronës komunale	19,100	19,100	12,125	63,48	63,48
6	Pagesat lidhur me automjetet	46,300	66,300	62,607	135,22	94,43
7	Certifikatat dhe dokum. Zyrtare	52,500	97,500	86,288	164,36	88,50
8	Tatimi në pronë	123,000	146,000	200,428	162,95	137,28
9	Të hyrat tjera- pjes. Në tender	2,250	2,250	2,300	102,22	102,22
10	Të hyrat indirekte	102,391	99,391	81,189	79,29	81,69
I	Gjithsej Administrata	530,541	642,750	656,270	123,70	102,10
1	Participimi-qerdhet	20,000	23,780	28,804	144,02	121,13
2	Arsimi fillor	5,000	1,640	1,900	38,00	115,85
3	Arsimi I mesëm	3,000	22,580	27,459	915,30	121,61
II	Gjithsej Arsimi	28,000	48,000	58,163	207,73	121,17
1	Participimi në Shëndetësi	69,200	57,517	56,869	84,05	101,12
III	Gjithsej Shëndetësia	69,200	57,517	56,869	84,05	101,12
	Gjithsej(I+II+III)	627,741	748,267	771,302	122,87	103,08

Tabela e mësipërme, paraqet planifikimin -rishikimin dhe arkëtimin (arkëtimi është shuma e mjeteve që është arkëtuar gjatë vitit, porë jon e akorduar) e të hyrave nga burimet vetanake gjatë vitit 2010, ku vërehet se objektivi i planifikuar është realizuar 122,87%; ndërsa realizimi i krahasuar me rishikim është realizuar në përqindje 103,08%.

Të hyrat e burimeve vetanake të realizuara në vitin 2010, të krahasuara me një vit më parë paraqesin një rritje të të hyrave vetanake për +13,67%. Edhe në vitin fiskal 2010 të hyrat nga tatimi në pronë e kanë ndikimin më të lartë në rritjen e të hyrave nga burimet vetanake.



Komuna i menaxhon shpenzimet përmesë përdorimit të llogarisë së vetme të Thesarit „LLVTH” e cila mbulohet në Autoritetin Bankar të Kosovës (AQBK) me këtë nr.1000650070000022. Procesi i shpenzimeve është i përfshirë në disa koncepte kryesore në shpenzimin e parave publike dhe atë:

- * Ndarja buxhetore,
- * Akordimi i fondeve,
- * Inicimi i shpenzimeve,
- * Zotimi i fondeve,
- * Prokurimi,
- * Pagesa e faturës dhe
- * Lëshimi i fondëve nga llogaria bankare.

Për t'u bërë ngritja dhe promovimi i ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektshmërisë në drejtim të shpenzimit të parasë publike, nga sektorët kryesorë me kohë është bërë përgatitja e parashikimit paraprak të zotimeve dhe rrrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2010. Në këtë drejtim ndikim të madh ka pasur aplikimi i metodës për ndarjen e buxhetit komunal për njësi më të ulëta buxhetore (drejtorate-zyre) komunale dhe nënëprograme.

Dihet se në bazë të dispozitave ligjore, buxheti është i ndarë për nga funksioni në programe-nënëprograme, ndërsa për nga karakteri ekonomik i shpenzimeve në pesë kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve, zhvillimin e të cilave e pasqyrojnë tabelat në vijim:

Tabela.4- Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve - Sektori i Administratës

Nr	Kategorit e Shpenzimeve	Planifikimi	Realizimi	% ndaj planit
1	Paga dhe Mëditje	670,636.00	700,530.00	104.46
2	Mallra dhe Shërbime	258,143.00	253,884.00	98.35
3	Sh.Sherb.Komunale	44,848.00	44,778.00	99.84
4	Subvencione - Transfere	56,009.00	53,632.00	95.76
5	Shpenzimet Kapitale	2,214,478.00	2,077,649.00	93.82
6	Raporti përmbljedhës	3,244,114.00	3,130,473.00	96.50

Tabela.4.1- Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve - Sektori i Arsimit


Nr	Kategorit e Shpenzimeve	Planifikimi	Realizimi	% ndaj planit
1	Paga dhe Mëditje	3,103,322.00	3,028,047.00	97.57
2	Mallra dhe Shërbime	321,884.00	302,098.00	93.85
3	Sh.Sherb.Komunale	64,877.00	64,877.00	100.00
4	Subvencione - Transfere	20,000.00	20,000.00	100.00
5	Shpenzimet Kapitale	232,985.00	232,756.00	99.90
6	Raporti përmbljedhës	3,743,068.00	3,647,778.00	97.45

Tabela.4.2- Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve - Sektori i Shëndetësisë

Nr	Kategorit e Shpenzimeve	Palinifikimi	Realizimi	% ndaj planit
1	Paga dhe Mëditje	831,114.00	828,169.00	99.65
2	Mallra dhe Shërbime	177,424.00	177,003.00	99.76
3	Sh.Sherb.Komunale	40,270.00	40,270.00	100.00
4	Subvencione - Transfere	23,691.00	23,691.00	100.00
5	Shpenzimet Kapitale	11,683.00	11,683.00	100.00
6	Raporti përmbledhës	1,084,182.00	1,080,816.00	99.69

Tabela.4.3- Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve janar-dhjetor 2010 buxheti komunal

Nr	Kategorit e Shpenzimeve	Palinifikimi	Realizimi	% ndaj planit
1	Paga dhe Mëditje	4,605,072.00	4,556,745.00	98.95
2	Mallra dhe Shërbime	757,451.00	732,985.00	96.77
3	Sh.Sherb.Komunale	149,995.00	149,925.00	99.95
4	Subvencione - Transfere	99,700.00	97,323.00	97.62
5	Shpenzimet Kapitale	2,435,780.00	2,322,088.00	95.33
6	Raporti përmbledhës	8,047,998.00	7,859,066.00	97.65



Tabelat nr. 4.4.1 dhe 4.2, paraqesin gjendjen e zhvillimit të buxhetit komunal lidhur me shpenzimet sipas sektorve kryesorë dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve; ndërsa tabelat nr. 4.3, pasqyrojnë përmbledhjen e të dhënave për zhvillimin e buxhetit komunal sipas kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve.

Nëse bëjmë krahasimin në mes të objektivit (8,047,998€) dhe realizimit (7,859,066€), vërehet se për vitin raportues objektivi është realizuar 97,65%. Nëse bëjmë një krahasim të shpenzimeve në mes të vitit raportues me një vit më parë, vërehet se kemi një rritje të shpenzimeve për +11,05%. Nëse bëjmë krahasimin e kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve të vitit 2010 me vitin 2009, do të kemi këtë gjendje:

1. Kategoria e shpenzimeve paga dhe mëditje ka patur rritje për: 11,13%;

2. Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime ka patur zvoglim për: 1,95%,
3. Kategoria e shpenzimeve për shërbime komunale ka patur zvoglim për: 7,78%,
4. Kategoria e shpenzimeve subvencione -transfere ka patur rritje për: 42,07%, dhe
5. Kategoria e shpenzimeve kapitale ka patur një rritje të theksuar për: 16,20%.

Edhe pse të gjitha faturat e paraqitura për pagesë janë paguar në afatin ligjor, kemi fatura të mbetura për pagesë si bartje në buxhetin e vitit 2011. Faturat e pa paguara janë si rezultat i rrjedhës së shpenzimeve nga mesi i muajit nëntor dhe dhjetor, kryesisht si shpenzime të shërbimeve komunale, të cilat janë pranuar për pagesë nga sektorët kryesor pasë mbylljes së sistemit të pagesave nga ana e Departamentit të Thesarit-MEF.

Shuma e faturave të pa paguara në Sektorin e Administratës është në shumë prej: 28,883€, në Sektorin e Arsimit shuma prej: 29,726€, dhe në Sektorin e Shëndetësisë shuma prej: 29,072€. Faturat në fjalë kanë të bëjnë me shpenzimet operative, bartja e të cilave është e lejshme, porë me qëllim që pagesa të bëhet brenda afatit ligjor me buxhetin vijues.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale, kemi një bartje të mjeteve në emër të projekteve të pa përfunduara në shumë prej: 123,568€, numëri i projekteve është 6, shuma e këtyre mjeteve bartet pa ndoni shkurtim, ngase janë nga të hyrat e burimeve vetanake. Shuma e përgjithshme e mjeteve për bartje në vitin buxhetor 2011 është prej: 206,815€, shpenzimi i këtyre mjeteve do të bëhet sipas vendimit të Kuvendit Komunal.

Numëri i të punësuarve me buxhetin e vitit 2010 ka qenë 1301, dhe injejtë është rrespektuar pa ndoni tejkalim. Detyrimet kontigjente janë përmbushur sipas parashikimit të bërë me buxhet, vlera e të cilave ka qenë në shumë prej: 30,070€.



Kryetari i Komunës
Nexhat Demaku